

# Inspektori i Lartë i Drejtësisë

## Newsletter

# Janar 2021



## Kush jemi?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) është një institucion i ri, i pavarur kushtetues, i ngritur në 1 Shkurt 2020. ILD është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Inspektor i Lartë i Drejtësisë është zgjedhur Z. Artur Metani, i cili e ushtron detyrën që prej dt. datë 20.01.2020 bazuar në Vendimin nr. 2/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë".

## Kuadri ligjor

- ◇ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- ◇ Ligj nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
- ◇ Ligj nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"
- ◇ Vendim I Këshillit të Ministrave për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit.

## Përmbajtja

Kush jemi? .....	1
Procesi i ankimimit nw ILD .....	2
Statistika Janar 2021 .....	2
Intervistë për News 24 .....	3
OBDAT në ILD .....	3
Fondacioni AADF në ILD .....	4
Takim pune me Euralius .....	4
Intervistë për "Java në RTSH" ..	5

[Kliko](#) për të lexuar Udhëzuesin e ankesave

## Procesi i ankimimit pranë ILD

Çdo person fizik ose juridik mund të paraqesë ankesë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kur ka të dhëna të besueshme se një magjistrat (gjyqtar ose prokuror) ka kryer shkelje disiplinore, ankesa paraqitet tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë nga subjektet e mëposhtme:

- Ministri i Drejtësisë;
- Një anëtar i vetëm i Këshillit (Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë)
- Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë.

[Akesat kryhen në tri mënyra:](#)

⇒ Duke plotësuar formularin e ankesës online në ëëbin zyrtar [ild.al](http://ild.al).

⇒ Duke shkarkuar [formularin e ankesës](#) dhe ai, së bashku me dokumente të tjera (sipas dëshirës), të dërgohen në adresën e postës elektronike [info@ild.al](mailto:info@ild.al).

⇒ Në mënyrë direkte: Ankuesit mund të paraqiten edhe fizikisht pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të plotësuar një formular ankesë, me asistencë nga stafi i sektorit të aneksave. Ky shërbim ofrohet nga e hëna në të premte nga ora 10.00 deri në orën 13.00.

*“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”*

### Plotësimi i ankesës

Formulari i ankesës mund të plotësohet me shkrim dore ose me kompjuter. Nëse e plotësoni me shkrim dore, ju lutemi të përdorni shkronja shtypi, në mënyrë që teksti të jetë i lexueshëm. Pasqyro-ni në mënyrë të saktë emrin e subjektit ndaj të cilit ankoheni dhe institucionin ku ushtron detyrën. Parashtroni në mënyrë të saktë faktet në lidhje me shkeljen e pretenduar të gjyqtarit/prokurorit, të një prej anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, apo Prokurorit të Përgjithshëm. Në formularin e ankesës identifikoni sa mundeni nëse shkelja disiplinore e pretenduar lidhet me ushtrimin e funksionit, është kryer jashtë ushtrimit të funksionit apo për shkak të kryerjes së një vepre penale.

## STATISTIKA

Gjatë muajit **Janar** janë depozituar **111 ankesa** pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

*Konkretisht:*


**103 ankesa** kanë ardhur nga qytetarë

**7 ankesa** kanë ardhur nga institucione për kompetencë, si KLP, ILDKPKI, PP, etj,

**1 ankesë** ka ardhur nga Organizata e Sindikates se Pavarur e Naftes Patos.

Për të gjitha ankesat e muajit janar 2021 është realizuar konfirmimi standard i administrimit të tyre.

Ankesat që kanë si subjekt të tyre magjistratë prokurorë e gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në fazat e ndryshme të procesimit, si shqyrtim fillestar, verifikim apo arkivim me projekt-vendimet përkatëse.





Inspektori i Lartë i Drejtësisë,  
Z. Artur Metani, gjatë intervistës  
me gazetaren Klodiana Lala të  
zhvilluar në fillim të Janarit

[Kliko për të ndjekur intervistën e plotë.](#)

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ARTUR METANI TAKON PËRFAQËSUESËN E OPDAT, ZNJ. MICHELLE LAKOMY



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani priti në takim këshilltaren ligjore rezidente të programit OPDAT pranë ambasadës së SHBA në Shqipëri, znj. Michelle Lakomy.

Z. Metani e njohu znj. Lakomy me punën e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve

disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve si dhe me vizionin e këtij procesi, si një ekuilibër mes parimeve të interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe pavarësisë së magjistratëve.

Këshilltarja ligjore e OPDAT, znj. Lakomy shprehu gatishmërinë për të asistuar zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në forcim kapacitetesh dhe ekspertizë profesionale.

Z. Metani dhe znj. Lakomy bashkëndanë vullnetin për bashkëpunim mes zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe programit OPDAT të departamentit të drejtësisë së SHBA.

### Intervistë për News 24

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani ka zhvilluar një bashkëbisedim me gazetaren Klodiana Lala mbi punën e institucionit në 11 muaj funksionim dhe mbi efektet e pritshmëritë e reformës në drejtësi. Z. Metani nënvizoi se reforma e thellë kushtetuese, ligjore dhe institucionale, të cilës iu nënshtroa sistemi i drejtësisë, me një arkitekturë të re, kërkon kohën e vet, pasi sistemi është në vështirësi por mekanizmi ka filluar të lëvizë dhe tani është koha për rezultate.

“Tani fillon sfida tejet e rëndësishme, zbatimi i kompetencave që këto institucione kanë dhe realizimi i qëllimit, për të cilin këto institucione u krijuan, si kthimi i besimit të publikut, dhënia e një drejtësie të paanshme jashtë interesave të çdo fushe, e kështu me rradhë”.

Lidhur me filozofinë e punës së institucionit që drejton, z. Metani tha se duke balancuar interesin publik e pavarësinë e magjistratëve, padyshim që gjyqtarë e prokurorë që shkelin ligjin, duhet të kenë frikë e do përballen me pasojat që parashikon ligji.

“Ajo që unë mendoj se është e rëndësishme është që institucionet po tregojnë se mekanizmi ka filluar të funksionojë dhe jam plotësisht dakord me opinionin e përgjithshëm, që qytetarët kanë nevojë të shohin rezultate. Tashmë është koha e rezultateve dhe jo më e justifikimeve, sigurisht duke e balancuar kërkesën për rezultate me sfidat. Padyshim, ata gjyqtarë dhe prokurorë që kanë shkelur ligjin, apo që kanë shkelur interesat e shenja të dhënies së drejtësisë, duhet të kenë frikë. Ka ikur koha, që gjyqtarët e prokurorët që luajnë me interesa publike pa patur pasoja”.

## ILD nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit për programin e zhvillimit të lidershit me AADF

Inspektori i Lartë i Drejtësisë takon bashkëdrejtuesit e fondacionit shqiptaro-amerikan për zhvillim

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani priti në takim bashkëdrejtuesit ekzekutivë të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), z. Martin Mata dhe z. Aleksandër Sarapuli, si dhe menaxheren e projektit LEAD Albania, znj. Elvana Kurti.

Duke vlerësuar rolin e Fondacionit ndër vite në zhvillimin e një shoqërie demokratike, por edhe ekonomie tregu të qëndrueshme në Shqipëri, Inspektori i Lartë i Drejtësisë prezantoi fokusin e punës dhe vizionin e institucionit, në drejtim të krijimit të një kulture pavarësie, profesionalizmi dhe efektiviteti në tërësinë e korpusit të magjistratëve në Shqipëri.

Z. Mata dhe z. Sarapuli paraqitën eksperiencën e projekteve të AADF dhe mundësitë e bashkëpunimit me zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për forcim kapacitetesh profesionale, përmes programeve të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, ide që u mirëpritën nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Një memorandum mirëkuptimi u nënshkrua mes Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) për Programin për zhvillimin e lidershit LEAD Albania. Ky program synon t'u sigurojë profesionistëve të rinj dhe të talentuar shqiptarë përvoja të drejtpërdrejta në procesin e qeverisjes së Shqipërisë.



*Memorandumi i mirëkuptimit*



## Takim pune me ekspertë të Euralius për sistemin elektronik të ankesave pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani zhvilloi një takim pune zj. Anita Mihailova dhe me ekspertë vendas të misionit EURALIUS, mbi zhvillimin e sistemit elektronik të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ngritja e këtij sistemi inteligjent sjell një sërë lehtësish, si përdorimi i të dhënave në kohë reale, gjenerim i informacionit të saktë, me anë të metodologjisë digjitale dhe "paperless", duke krijuar akses të lehtë për përdoruesit e këtij sistemi.

Ky takim pune u zhvillua në kuadër të informimit të punonjësve të ILD-së për përmirësimin e sistemit dhe do pasohet me trajnime për



## Inspektorët magjistratë janë të domosdoshëm për punën në ILD

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dha një intervistë për gazetarët Preç Zogaj e Lorenc Vangjeli në emisionin “Java” në RTSH, mbi vitin e parë të punës së institucionit që drejton.

Ndër sfidat gjatë vitit të parë të punës, z. Metani veçoi pasjen e vetëm një inspektori-magjistrat në dispozicion, kur zyra e ILD-së ka funksion organik hetimin e procedimin disiplinor përmes inspektorëve me profil gjyqarë e prokurorë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë tha se interesi i ulët për aplikime, në nivelin zero nga rradhët e gjyqarëve, lidhet me nivelin e lartë të kriterëve të kërkuara, 13 vjet eksperiencë, po aq sa nevojiten

për të kandiduar për anëtar në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye, z. Metani shpjegoi propozimin e bërë për uljen e këtij kufiri, pra që kandidatët për inspektorë të kenë kriteret që kërkohen për një gjykatë apeli, 7 vjet, në mënyrë që të rritet grupi i njerëzve që do përzgjidhen. “Unë mendoj se gjyqarët duhet të jenë pjesë shumë e rëndësishme e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, së pari për punën e balancës mes inspektorëve magjistratë me ata jo magjistratë sepse duhet të vijin edhe njerëz nga sistemi për të ruajtur pavarësinë e bindjes së brendshme të vendimmarrjes, që një gjyqar e ndjen më shumë, se një person që nuk është



*“Më parë fola për pavarësinë e gjyqarëve dhe sigurisht që ILD nuk mund të konsiderohet si çekan në kokën e gjyqarëve, por nga ana tjetër, asnjë gjyqar që ka kryer, do kryejë apo mendon të kryejë shkelje të nivelit disiplinor, pra të kompetencës që institucioni im përfaqëson, nuk do shkojë pa u ndëshkuar. Ka marrë fund kultura e pandëshkueshmërisë”.*

në sistem. I pyetur për premtimin e bërë në nisje të detyrës për shqyrtimin e rasteve të lirim të dënuarve me burgim të përjetshëm, z. Metani tha se përveç rasteve të magjistratëve të proceduar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë këtij viti, inspektimi tematik vijon dhe në rast konstatimi të një paligjshmërie apo shkeljeje disiplinore, ILD ndërhyr sipas kompetencave që i jep ligji.

I pyetur nëse reforma në drejtësi ka ngushtuar ndikimin e politikës në sistemin e drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u shpreh i bindur për këtë efekt. “Absolutisht po! Jam i bindur kur them “po!”, sepse kushtetuta dhe ligji sot

nuk krijojnë asnjë mundësi, që institucionet në procesin e vendimmarrjes së tyre të kenë ndikim të paligjshëm, politik apo çdo lloj tjetër.”

“Reforma në Drejtësi është një nga gjërat më të rëndësishme që ka ndodhur në këtë vend 30 vitet e fundit ,sipas gjykimit tim. Duke pasur parasysh se SHBA dhe BE janë partnerët strategjikë të Shqipërisë, dhe reforma në drejtësi mori mbështetje në çdo pikëpamje prej tyre, gjë që u reflektua edhe me miratimin në kuvend me 140 vota të deputetëve, do të thotë që edhe për shoqërinë është prioritet madhor reforma në drejtësi dhe zbatimi, efikasiteti e rezultati i saj.”

Sipas z. Metani sfidë është zbatimi i kompetencave të çdo institucioni të dalë nga reforma, por edhe bashkëpunimi mes institucioneve, për t’i bërë këto institucione funksionale sepse ligji është aty dhe kushtetuta është aty. “Suksesi apo dështimi i një institucioni të drejtësisë varet nga të tëra institucionet e drejtësisë. Personalisht unë dua që kur të iki, të iki me mendimin që u mundova dhe vura tullën time në murin e madh të zhvillimit të Shqipërisë.”

[Klikoni](#) për të ndjekur intervistën e plotë.



Janar 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara  
Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD



## KONTAKT ILD

ËEB: [ild.al](http://ild.al)

EMAIL: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Sheshi "Nënë Tereza"

Tiranë, Shqipëri



[@Inspektori\\_i\\_Larte\\_i\\_Drejtësisë\\_Artur\\_Metani](https://twitter.com/Inspektori_i_Larte_i_Drejtësisë_Artur_Metani)  
[@ILD\\_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë](https://www.youtube.com/channel/UC...)